

RELACION TEKNIK

OBJEKTI: RIKONSTRUKSION I PARQEVE MEMORIALE

Mbi hartimin e projektit preventivit për objektin :
“RIKONSTRUKSION I PARQEVE MEMORIALE”

I. HYRJJE

Varrezat e Dëshmoreve janë ndërtuar në vitin 1971, në një pozicion të dukshëm, në kodrën ndërmjet Pallatit të Brigadave dhe Senatoriumit, ndarë prej rrugës Elbasanit, përkundrejt qytetit të Tiranës. Është një kompleks monumental që zotëron fushëpamjen e Tiarnës. Në këtë kompleks përfshihen monumenti “Nëna Shqipëri” I vendosur në qendër, parcelat e vareve të dëshmorëve të atdheut, si edhe godina e shërbimit të administratës që menaxhon parkun memorial.

II. OBJEKTI I RELACIONIT

Nisur nga gjendja faktike e objektit shërbimit të administratës, nga ana e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit është menduar që të bëhet rikonstruksioni i plotë dhe kthim në gjendje funksionale si dhe të bëj disa ndërhyrje të nevojshme inxhinierike të cilat shërbejnë për ndalimin e fenomeneve të erozionit dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së objektit. Për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nga ndërtimi dy muret mbajtëse kryesore të parcelave kanë pësuar dëmtime dhe shëmbje duke rrezikuar shkatërrimin e parcelave të varreve. Si rezultat i kushteve atmosferike muret në pjesën më të madhe të tyre kanë pësuar dëmtime të riparueshme gjithashtu dhe pllakat e gurit të gdhendur të veshjes janë dekompozuar dhe nuk mund të riperdoren. Për këtë arsye është parë e nevojshme që të bëhet rindërtimi i tyre në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e parcelave të varreve. Në të njëjtën situatë ndodhet muri dhe kangjellat e rrethimit të jashtëm nga rrethrotullimi i Sautit deri tek kufiri lindor i Varrezave të Dëshmorëve

III . GJENDJA EGZISTUESE E OBJEKTIT

- Pamje e fasadës së objektit ku duket qartë degradimi dhe gjendja shumë e keqe e mureve, suvatimit, dymëve dhe dritareve





- Pamje e ambjenteve të brendshme që tregojnë rrezikshmerinë dhe jofunksionalitetin e ambjenteve të kësaj ndërtese, duke mos plotësuar kushtet për sigurinë dhe qëndrueshmërinë.





- Pamje e mureve kufizues së parcelave dhe murrit të rrethimit





IV. PUNIMET QE PARASHIKOHET TE KRYHEN

Duke parë gjendjen faktike të objektit të përshkruar më sipër është e nevojshme që rikonstrukcioni I tij të përqëndrohet në këto masa inxhinierike për ndërtesën:

- Të priset pjesa e soletës që është shkëputur dhe përbën rezik dhe të bëhet soletë e re b/a.
- Të hiqen shtresat e suvatimit në të gjithë sipërfaqen e objektit, brenda edhe jashtë dhe të ribëhen.
- Të hiqen dhe të zëvendësohen shtresat hidroizoluese të soletës në gjithë sipërfaqen.
- Të hiqen dhe të zëvendësohen pllakat e shtrimit dhe shtresat hidroizoluese dhe niveluese në të gjithë sipërfaqen.
- Të hiqen dhe të zëvendësohen dyer dhe dritare, të brendshme edhe të jashtme
- Të hiqen dhe të zëvendësohen instalimet dhe pajisjet elektrike dhe hidraulike
- Të hiqen dhe të zëvendësohen pajisjet hidrosanitare
- Të hiqen dhe të zëvendësohen sistemi I kullimit te ujrave të shiut..

Për Murin jugor të parces

Muri jugor ka një gjatësi prej 195 ml. Ky mur është ndërtuar me themel betoni dhe muraturë me tulle silikate $b= 30$ cm dhe është i veshur totalisht me pllaka guri të gdhendur $t= 10$ cm. Në pjesën më të madhe muri është shembur duke shkaktuar dëmtim dhe të shtresës me mermer të parces me një sipërfaqe rreth 225 m². Eshtë menduar që muri te ribehet mur betonarme dhe të vishet me pllaka guri të gdhendur 10 cm duke siguruar qëndrueshmëri dhe jetgjatesi më të madhe dhe veshja me pllaka guri për te mos humbur origjinalitetin. Gjithashtu parashikohet që të ribëhet shtresa me pllaka mermeri dhe shtresat poshtë saj që janë dëmtuar.

Për Murin verior të parces

Muri verior ka një gjatësi prej 169 ml. Ky mur është ndërtuar me themel betoni dhe muraturë me tulle silikate 30 cm dhe është i veshur totalisht me pllaka guri 10 cm. Ne pjesën më të madhe muri është shembur. Eshtë menduar që muri te ribehet mur betonarme dhe të vishet me pllaka guri 10 cm duke siguruar qëndrueshmëri dhe jetgjatësi më të madhe dhe veshja me pllaka guri për të mos humbur origjinalitetin.

Rrethimi i jashtëm nga rrethrotullimi I Saukut deri tek kufiri lindor

Rrethimi i jashtem nga rrethrotullimi i Saukut deri tek kufiri lindor tek Varrezat e Deshmoreve ka nje gjatesi prej 380 ml duke perfshire edhe porten hyrese jugore (10ml). Ky rrethim eshte ndertuar me temel betoni, kollona betonarme dhe kangjella metalike me lartesi 2. Ne pjesen me te madhe themeli dhe kollonat e tij jane shembur duke bere qe rrethimi te jete jofunksional. Edhe kangjellat metalike jane demtuar ose mungojne. Eshte menduar qe rrethimi te ribehet, bashke me porten hyrese.

V. KONKLuzionET

Mbështetur në gjendjen faktike të objektit të konstatuar nga vëzhgimet e bëra në terren si dhe nga mendimet dhe propozimet e ndryshme të marra nga specialist të fushave u paraqitën në këtë project detajet arkitektonike dhe konstruktive për rikonstruksionin e plotë dhe masat inxhinierike të nevojeshme.

Rikonstruksioni dhe rikonceptimi I objektit do të bëhet duke ruajtur origjinalitetin e tij dhe duke e rikthyer funksional për qëllimin e ndërtuar.

